



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi- Skupština- Assembly



REPUBLIKA SLOVENIJA
DRŽAVNI ZBOR

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT
NË MES TË KUVENDIT KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SLOVENISË
DHE KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Janari i vitit 2008 shënoi përfundimin e Projektit të AER-it “Mbështetja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës”, në bazë të së cilës *Assemblée nationale* e Francës, *Bundestagu* gjerman, *Kuvendi Kombëtar i Sllovenisë*, *Chambre des Représentants* e Belgjikës dhe Instituti Francez në Paris la Defense, kanë vepruar si Konzorcium për të mbështetur Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Brenda kornizës së Projektit, ekspertët nga Asambleja Nacionale e Sllovenisë kanë hartuar disa propozime që lidhen me buxhetin dhe menaxhimin financiar, bibliotekën dhe arkivin, dokumentacionin dhe regjistrimin e postës, dhe mbi të gjitha organizimin e një administrate të qëndrueshme dhe të pavarur si kusht jetik për kualitetin e çdo kuvendi parlamentar.

Si rezultat i implementimit të Projektit dhe bashkëpunimit të mirë në nivel bilateral, është arritur përparim i dukshëm në vitet e kaluara.

Pas përfundimit të këtij Projekti, Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Kuvendi Kombëtar i Republikës së Sllovenisë u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin në suaza bilaterale.

Sekretarët e Përgjithshëm të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Sllovenisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë plotësisht të vetëdijshëm se Projekti “Mbështetja e mëtejme Kuvendit të Kosovës”, sado i suksesshëm të ketë qenë, nuk iu ka përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe as nuk i ka zgjedhur të gjitha problemet, dhe gjithsesi Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ballafaqohet me sfida të reja në muajt e ardhshëm.

Prandaj, të dy palët janë të pajtimit për të ruajtur kontaktin në mes të dy administratave të tyre dhe të ri-konfirmojnë gatishmërinë e tyre për shkëmbimin e ekspertëve, në baza bilatelare dhe brenda një kornize të re, mundësisht me ndihmën financiare të pjesëmarrësve tjerë dhe në bashkëpunim me ish anëtarët e Konzorciumit.

Kjo marrëveshje nuk përfshin detyrime financiare nga asnjëra palë nënshkruese e këtij memorandumi.

Bashkëpunimi do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2010.

Përgatitur në Lubjanë, më 24 qershor 2010.

Ismet KRASNIQI,

Sekretar i Përgjithshëm

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Mojca PRELESNIK,

Sekretare e Përgjithshme

Kuvendi Kombëtar i Republikës së Sllovenisë